



AAB College

KOLEGJI AAB

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

PROGRAMI (BSc) Infermieri e Përgjithshme

*RAPORTI I VLERËSIMIT TË STUDENTËVE PËR
PUNËN LABORATORIKE*

Raporti i hartuar nga:
Zyra e Cilësisë

Prill, 2024

HYRJE

Raporti i Zyrës së Cilësisë në Kolegjin AAB ofron një vlerësim zyrtar të praktikave të zhvilluara në laboratorët e institucionit. Përmes analizës së detajuar të të dhënave të mbledhura me pyetëtorin e realizuar me studentët, raporti jep një vështrim të qartë në perceptimet dhe mendimet e tyre lidhur me përvojën në laborator.

Pyetëtori për vlerësimin e praktikës në laborator për studentët e infermierisë synon të shqyrtojë përvojën e tyre në lidhje me shkathtësitë dhe mbështetjen që përfitojnë gjatë praktikës së tyre në laborator. Përqendrohet në disa aspekte kyçe të përvojës së studentëve, duke përfshirë:

- Qasjen ndaj procedurave infermierore,
- Aftësinë e studentëve për të praktikuar dhe përparuar në shkathtësitë praktike,
- Disponueshmërinë e mjeteve për implementimin e teorive të mësimin,
- Nivelin e njohurive të asistentit,
- Gatishmërinë e asistentit për të ofruar sqarime shtesë në raste të paqartësive.

Këto aspekte ofrojnë një shikim të gjerë në cilësinë e praktikës në laborator dhe ndihmojnë në identifikimin e fushave për përmirësim dhe rekomandimeve për avancimin e përvojës së studentëve në praktikën laboratorike të infermierisë.

Pyetëtori për vlerësimin e praktikave të zhvilluara në laboratorë, përmban pesë pyetje, ku studentët japin vlerësime duke përdorur një shkallë të Likerit me 3 nivele, nga "nuk pajtohem", "neutral" dhe "pajtohem". Për çdo pyetje të pyetëtorit, vlerësimet e përgjithshme të studentëve janë paraqitur në formë grafike. Pas analizës së rezultateve, raporti do të propozojë masat korrigjuese për të përmirësuar përvojën e studentëve në laborator.

VLERËSIMI I STUDENTËVE PËR PUNËN LABORATORIKE NË FAKULTETIN E MJEKËSISË

PROGRAMI BSC INFERMIERI


Tabela 1. Puna praktike në laborator

	NUK PAJTOHEM	NEUTRAL	PAJTOHEM	TOTAL
A keni përfituar shkathtësi të mjaftueshme për procedurat infermierore gjatë mbajtjes së praktikës në laborator?	1.05%	6.32%	92.63%	95
	1	6	88	
A ka pasur njohuri të mjaftueshme asistenti për stimulimin e shkathtësive praktike?	1.05%	3.16%	95.79%	95
	1	3	91	
A keni arritur të praktikoni dhe të përvetësoni shkathtësitë e demonstruara nga asistenti?	2.11%	3.16%	94.74%	95
	2	3	90	
A keni pasur në dispozicion të gjitha mjetet për implementimin e teorive të mësuarit në praktikë?	7.37%	28.42%	64.21%	95
	7	27	61	
A ka qenë i gatshëm asistenti të jap sqarime shtesë në rast të paqartësive?	0.00%	3.16%	96.84%	95
	0	3	92	

Në tabelën e mësipërme, u paraqit një përmbledhje e rezultateve lidhur me praktikën e zhvilluar të studentëve nga gjithsej 95 pjesëmarrës. Analiza e tabelës tregon se shumica e studentëve janë pajtuar (me një përqindje prej 92.63%) se kanë përfituar shkathtësi të mjaftueshme për procedurat infermierore gjatë praktikës në laborator. Një trend i ngjashëm shihet edhe në pyetjen e dytë, ku shumica e studentëve (95.79%) kanë vlerësuar se asistenti ka pasur njohuri të mjaftueshme për të stimuluar shkathtësitë praktike. Në pyetjen e tretë, vetëm 94.74% e studentëve shprehën se kanë arritur të praktikojnë dhe të përvetësojnë shkathtësitë e demonstruara nga asistenti. Në pyetjen e katërt, vetëm 64.21% e studentëve konfirmojnë se kanë pasur në dispozicion të gjitha mjetet për implementimin e teorive të mësuarit në praktikë. Në pyetjen e fundit, 96.84% e studentëve konfirmojnë se asistenti ka qenë i gatshëm të japë sqarime shtesë në rast të paqartësive.

Këto rezultate sugjerojnë se, përgjithësisht, studentët kanë përfituar nga praktika në laborator, megjithatë ka disa fusha që mund të nevojiten përmirësime, si sigurimi i të gjitha mjetet dhe disponueshmëria e asistentit për të ofruar ndihmë shtesë.

Figura 1. A keni përfituar shkathhtësi të mjaftueshme për procedurat infermierore gjatë mbajtjes së praktikës në laborator?




Në figurën e dhënë është paraqitur vlerësimi i studentëve në pyetjen se A keni përfituar shkathhtësi të mjaftueshme për procedurat infermierore gjatë mbajtjes së praktikës në laborator? Shumica prej 92.63% të studentëve raportojnë se kanë përfituar shkathhtësi të mjaftueshme për procedurat infermierore gjatë praktikës në laborator, një rezultat inkurajues. Një pjesë e vogël, vetëm 1.05% e studentëve, nuk pajtohen me përfitimin e tyre, një faktor që mund të kërkojë analizë shtesë për të kuptuar arsyet e këtij perceptimi të ndryshëm të studentëve. Ndërkohë, një përqindje 6.32% e studentëve kanë një qëndrim neutral, që sugjeron se ata mund të kenë dyshime ose kundërshti të përvojës së tyre.

Figura 2. A ka pasur njohuri të mjaftueshme asistenti për stimulimin e shkathtësive praktike infermierore gjatë mbajtjes së praktikës në laborator?




Në këtë figurë është paraqitur vlerësimi i studentëve në pyetjen se A ka pasur njohuri të mjaftueshme asistenti për stimulimin e shkathtësive praktike infermierore gjatë mbajtjes së praktikës në laborator? Shihet se shumica absolute e studentëve, rreth 95.79%, pajtohen se asistenti ka pasur njohuri të mjaftueshme për të stimuluar shkathtësitë praktike infermierore gjatë praktikës në laborator. Në krahun tjetër të spektrit, një përqindje e vogël, vetëm 1.05%, nuk pajtohen me këtë deklaratë. Ndërkohë, një përqindje më e vogël, 3.16%, janë në një pozicion neutral në lidhje me këtë çështje.

Figura 3. A keni arritur të praktikoni dhe të përvetësoni shkathhtësitë e demonstruara nga asistenti?




Në këtë figurë, shihet se një shumicë e madhe, rreth 94.74%, e studentëve janë pajtuar se kanë arritur të praktikojnë dhe të përvetësojnë shkathhtësitë e demonstruara nga asistenti. Në anën tjetër, një përqindje më e vogël, rreth 2.11%, nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa 3.16% janë në një pozicion neutral në lidhje me këtë çështje.

Figura 4. A keni pasur në dispozicion të gjitha mjetet për implementimin e teorive të mësuarit në praktikë?



Në grafikun e dhënë, shihet se një shumicë e madhe, rreth 64.21%, e studentëve janë pajtuar se kanë pasur në dispozicion të gjitha mjetet për implementimin e teorive të mësuarit në praktikë. Në anën tjetër, një përqindje më e vogël, rreth 7.37%, nuk pajtohen me këtë deklaratë, ndërsa një përqindje e mesme, 28.42%, janë në një pozicion neutral në lidhje me këtë çështje.

Figura 5. A ka qenë i gatshëm asistenti të jap sqarime shitesë në rast të paqartësive?



Në grafikun e dhënë, 96.84% e studentëve janë pajtuar se asistenti ishte i gatshëm të japë sqarime shitesë në rast të paqartësive. Nuk ka asnjë student që nuk pajtohet me këtë deklaratë. Një përqindje shumë e vogël, 3.16%, janë në një pozicion neutral në lidhje me këtë çështje. Kjo tregon se asistenti ka pasur një disponueshmëri shumë të mirë për të ofruar ndihmë dhe sqarime shitesë sipas nevojës së studentëve në rast të paqartësive.

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME

Bazuar në vlerësimet e studentëve për punën praktike që kanë ndjekur, ky raport përcakton një eksperiencë të suksesshme në fushën laboratorike. Përgjigjet e studentëve tregojnë se njohuritë e përfituara gjatë ligjeratave janë aplikuar me sukses në praktikën e laboratorit.

Vlerësimet e studentëve tregojnë se asistentët kanë demonstruar një nivel të lartë të përkushtimit dhe kompetencës gjatë udhëheqjes së praktikës në laborator. Studentët kanë shprehur një vlerësim pozitiv për njohuritë dhe aftësitë e asistentëve për të inkurajuar dhe përmirësuar shkathtësitë e tyre praktike. Kjo tregon se roli i asistentëve ka pasur një ndikim të rëndësishëm në përvojën e studentëve në laborator. Duke e vlerësuar pyetjen e adresuar rreth disponueshmërisë së mjeteve në laborator dhe duke kombinuar me komentet e studentëve, konstatohet se një numër i konsiderueshëm i tyre besojnë se ka mungesë të pajisjeve në laborator për të zhvilluar ose praktikuar të gjitha ushtrimet e nevojshme.

Sugjerimet kryesore, të cilat janë gjithashtu rekomandime për përmirësim në të ardhmen, janë:

- Asistentët të vazhdojnë të inkurajojnë dhe ofrojnë mbështetje për studentët në mënyrë që ata të përfshihen aktivisht në përvetësimin e shkathtësive.
- Të përmirësohet disponueshmëria e pajisjeve dhe mjeteve në laboratorë, duke e bërë kështu më lehtë për studentët të praktikojnë dhe të zhvillojnë aftësitë infermierore në një ambient më efikas dhe i përshtatshëm.
- Të ndërmerren veprime për të siguruar një ambient më komod dhe funksional në laborator, duke përfshirë mirëmbajtjen e sistemeve të klimatizimit për të garantuar një temperaturë të përshtatshme për studentët gjatë praktikës së tyre.